



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY
 Nr. Prot. Br. Prot. Prot No. 03-03/3536/17
 Dep. DPK
 Nr. 1 fag
 Broj stranica 03
 Nr. pages 03
 Datum 27-10-2017
 PRISTINE

DATE/A:	27.10.2017
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP 03-03/3391/17
PËR/ZA/TO:	z. Bujar TAHIRI, Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit – Ndërmarrja Publike “ KRU- Bifurkacioni “ sh.a. Ferizaj
CC:	z. Nazif ASLLANI, Kryeshef Ekzekutiv - Ndërmarrja Publike “KRU- Bifurkacioni “ sh.a. Ferizaj
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Blerja e veturave për nevoja të KRU “ Bifurkacioni “ sh.a. Ferizaj "

I nderuari z. Tahiri ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Blerja e veturave për nevoja të KRU “ Bifurkacioni ” sh.a. Ferizaj " me numër prokurimi: 600-17-4681-121 dhe me nr. të brendshëm: 600-17-012-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Blerja e veturave për nevoja të KRU “ Bifurkacioni ” sh.a. Ferizaj " me numër prokurimi: 600-17-4681-121 dhe me nr. të brendshëm: 600-17-012-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04/L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm Agjencia) me datë 20.10.2017, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-3391/17* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "**Blerja e veturave për nevoja të KRU "Bifurkacioni" sh.a. Ferizaj " me numër prokurimi: 600-17-4681-121 dhe me nr. të brendshëm: 600-17-012-121**", i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ndërmarrja Publike "KRU- Bifurkacioni " sh.a. Ferizaj.

Agjencia duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka hapur këtë rast nën dyshimin se Autoriteti kontraktues me rastin e hartimit të Specifikimeve teknike ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 28 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik. Agjencia fillimisht ka trajtuar dhe analizuar dokumentet në dispozicion në platformën **E-prokurimi** si: njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në platformën **E-prokurimi** Autoriteti kontraktues ka kërkuar që të furnizohet me vetura të reja për nevojat e Ndërmarrjes. Agjencia, pasi ka analizuar kërkesën e njësisë kërkuuese dhe dosjen e këtij tenderi, konstaton se Autoriteti kontraktues ka kërkuar 3 vetura për transport – pick- up me specifikimet teknike si në vijim: **automjeti duhet të jet i prodhuar në Bashkimin Evropian, vëllimi i motorit të jet 1550 cm³ - 1600 cm³, shpenzimet e karburantit urban max. 5.5 litra, extra urban max. 4.5 Litra si dhe të kombinuara max. 5.0 litra / 100 km. Autoriteti kontraktues gjithashtu ka kërkuar furnizimin edhe me 1 veturë për udhëtar – Limuzinë ku ka përshtetur specifikimet teknike si në vijim: automjeti duhet të jet i prodhuar në Bashkimin Evropian, vëllimi i motorit të jetë 1550 cm³ - 1600 cm³, fuqia e motorit 80 kW-90 kW, si dhe shpenzimet e kombinuara të karburantit max: 4.5 litra /100 km. Kërkesa këto për të cilat konsiderojmë se janë kufizuese dhe diskriminojnë prodhues të caktuar në treg.**

Autoriteti kontraktues më konkretisht Njësia Kërkuuese duhet të ketë kujdes dhe t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të mos jenë me vlera fikse, por të caktohet minimumi i kërkesave teknike dhe që të jenë të hapura për të gjithë operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimet e tilla. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik apo prodhues.

Bazuar në paragrafin 3 të nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik " Autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të artikujve të tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Gjithashtu bazuar në nenin 7 par. 4, të LPP-së thuhet se “Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik”.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimin e kënaqshëm me pajisje të tilla.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr materialin tenderik.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !